

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Faqe

2

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

4

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHPËPËRFSHIRËSE

5

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

6

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

7

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

8-34

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Aksionerëve së Shoqërisë BiCredit sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **BiCredit sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), siç është përshkruar në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me rregulloret dhe rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

mazars

Ukshi Hoti Str., 45/6 Build.,
10000, Pristina, Kosovo
Cert of Reg.: B11335597

28 prill 2022

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor




Pasqyra e Pozitës financiare
Më 31 Dhjetor 2021

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	16	269,604	552,273
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	14	3,460,958	3,192,306
Pasuritë tjera (parapagime)	15	20,230	3,039
Pasuritë e paprekshme	17	5,302	12,346
Prona dhe pajisje	18	39,641	68,951
Asete me të drejtë përdorimi	19	91,179	124,539
Gjithsej pasuritë		3,886,914	3,953,454
DETYRIMET			
Hua nga bankat	21	1,120,076	1,296,447
Qera financiare	20	95,839	131,463
Detyrime tatimore	20	258	7,037
Detyrimet tjera	20	50,653	38,406
Gjithsej detyrimet		1,266,826	1,473,353
EKUITETI			
Kapitali aksionar		2,300,000	2,300,000
Fitimi/(Humbja) e akumuluar		180,101	27,789
Fitimi/(humbja) periudhes		139,987	152,312
Gjithsej ekuiteti	22	2,620,088	2,480,101
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		3,886,914	3,953,454

Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe janë aprovuar në emër të IFJB më 19 prill 2022 nga:



Besa Jashari
 Kryeshef Ekzekutiv

Saranda Maksuti
 Departamenti i Financave



Shënimet shpjeguese në faqet 8-34 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesi		520,393	500,376
Shpenzimet e interest		(70,584)	(75,562)
Të ardhurat neto nga interesi	8	449,809	424,814
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		40,846	35,261
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet		-	(312)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	9	40,846	34,949
Kthimi nga kreditë e shlyera	10	4,210	3,254
Të ardhura të tjera operative	11	-	3,562
Gjithsej të ardhurat operative		4,210	6,816
Zhvlerësimi i huave		(33,142)	(12,764)
Shpenzime të tjera operative		(305,067)	(285,359)
Gjithsej shpenzime operative	12	(338,209)	(298,123)
Fitimi para tatimit		156,656	168,456
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	13	(16,669)	(16,144)
Fitimi/(humbja) neto e vitit		139,987	152,312
Te hyra te tjera gjithperفشیره		-	-
Totali I fitimit / (humbjes) gjithperفشیره per vitin		139,987	152,312

Shënimet shpjeguese në faqet 8-34 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

	Kapitali Aksionar	Fitimet/(humbjet) e mbartura	Fitim/ humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	2,300,000	(37,700)	65,489	2,327,789
Fitim/Humbja i/e vitit			152,312	152,312
Transferim në humbje të mbartura		65,489	(65,489)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	2,300,000	27,789	152,312	2,480,101
Fitim/Humbja i/e vitit			139,987	139,987
Transferim ne humbje te mbartura		152,312	(152,312)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	2,300,000	180,101	139,987	2,620,088

Shënimet shpjeguese në faqet 8-34 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi/Humbja para tatimit	156,656	168,456
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Zhvlerësimi i pronës dhe pajisjeve	63,805	63,475
Amortizimi i pasurive të paprekshme	7,044	7,044
Humbja/(Fitim) nga shitja e pronave dhe pajisjeve	-	5,082
Humbje nga kreditë e rëna në vlerë	33,142	12,765
Te ardhura nga rimatja IFRS 16	-	(3,562)
Tatim fitimi jo monetary	-	(7,014)
Shpenzimet e interest	70,584	75,562
Të ardhura nga interesi	(520,393)	(500,376)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	(40,846)	(35,261)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet:</i>		
Kredi dhe paradhënie për klientët	(288,956)	61,481
Pasuri të tjera	(7,988)	59
Tarifa dhe komisione të arkëtuara	32,196	28,229
Detyrime të tjera dhe provizione	5,468	(11,350)
Interesi i arkëtuar	516,205	500,143
Interesi i paguar	(70,584)	(75,266)
Tatimi në fitim i paguar	(25,872)	(11,330)
<i>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative</i>	(69,539)	278,137
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
Pagesat për blerjet e pronës dhe pajisjeve	(1,135)	-
Arkëtimet nga shitja e pronës , pajisjeve dhe impianteve	-	16,949
<i>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese</i>	(1,135)	16,949
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	(176,371)	(27,571)
Ripagimi i qerasë financiare	(35,624)	(26,635)
<i>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese</i>	(211,995)	(54,206)
<i>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të saj</i>	(282,669)	240,880
Paraja dhe ekuivalentët e saj ne fillim të vitit	552,273	311,393
<i>Paraja dhe ekuivalentët e saj ne fund të vitit</i>	269,604	552,273

Shënimet shpjeguese në faqet 8-34 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informatat e përgjithshme

"BiCredit" SH.A është e regjistruar në qendrën e regjistrimit të bizneseve(MTI) në Prishtinë, me datën 25.01.2017, me nr. të biznesit 71354091 dhe me nr. të protokolit 31A0000199 me adresë Rr. Hamëz Jashari - Ferizaj.

Me statusin aktual ligjor, si Shoqëri Aksionare ka filluar të operojë me 12.10.2017.

Bordi i Drejtorëve aktualisht përbëhet nga këta anëtarë:

Basri Fazliu - Kryetar i Bordit Drejtues

Sadullah Syla – Nënkyetar i Bordit Drejtues

Medain Hashani – Anëtar i Bordit Drejtues

Aktivitetin kryesor ka huadhënien dhe shërbimin e pagesave të ndryshme.

2. Bazat e përgatitjes

Politikat kryesore kontabël të përshtatura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë theksuar më poshtë. Këto politika janë aplikuar vazhdimisht në të gjitha vitet e prezantuara, përveç nëse është theksuar ndryshe.

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Nenin 53 të Ligjit nr. 04/L-093, të datës 11 maj 2012, "Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo Bankare".

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime rregullative dhe pasqyrojnë rregullat e kontabilitetit dhe rregulloret e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës ("Rregullat e BQK-së"). Rregullat e BQK-së bazohen në vendimet relevante ligjore që definojnë aplikimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar ("SNRF") në Kosovë, por rregullat e BQK-së në veçanti kërkojnë zbatimin e disa trajtimeve të kontabilitetit të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e veçanta të SNRF-së, dhe pasqyrat financiare nuk duhet të lexohen si të përgatitura në përputhje me SNRF.

Përveç kësaj, udhëzimet e BQK-së nuk kanë miratuar parimet e standardeve të reja dhe të ndryshuara të SNRF-ve efektive për periudhat raportuese që fillojnë më 31 dhjetor 2018, më së shumti SNRF 9: Instrumentet Financiare

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2. Bazat e përgatitjes(vazhdim)

2.3 Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i kompanisë ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të vazhduar në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burimet për të vazhduar biznesin në të ardhmen e parashikueshme.

Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedh dyshime të konsiderueshme në aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi.

Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

2.4 Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro ("EUR"), që është monedha funksionale e IFJB-së.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurat dhe shpenzimet. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet e kontabilitetit janë të njohur në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekura. Veçanërisht, informacion rreth fushave të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e kontabilitetit politikat që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 5.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto deklarata financiare.

3.1 Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbret pagesat në të holla të ardhshme dhe arkëtimet në të ardhmen. Jetëgjatësia e pritur e aktivit ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, institucioni vlerëson të ardhmen, flukset monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha tarifat dhe shumat e paguara ose të pranura që janë pjesë përbërëse pjesë e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejtë blerjen ose lëshimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.2 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit mbi një aktiv financiar ose detyrimi përfshihet në matjen e normës efektive të interesit. Kur nuk pritet një angazhim kredie për të rezultuar në nxjerrjen e një kredie, tarifat e lidhura me angazhimin e kredisë njihen në bazë të linjës së drejtë gjatë periudhës së angazhimit. Të ardhurat e tjera të tarifave dhe komisioneve njihen si shërbime të lidhura.

3.3 Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

IFJB fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet për klientët dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet e shitjet e rregullta) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur IFJB bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus (për një zë që nuk matet më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Referohu polikave kontabël 3.4, 3.5 dhe 3.6

(iii) Çregjistrimi

IFJB cregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parave nga aktiviteti financiar, ose kur ajo transferon të drejtat për të manë rrjedhë parash kontraktuale në një transaksion, në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësive së aktivitetit financiar janë transferuar ose në të cilat IFJB as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësive dhe nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

IFJB cregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprere apo perfunduar.

IFJB merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivitetet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferime të aktiveve me mbajtjen e të gjitha ose substancialisht të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve, janë për shembull, huazimi i letrave me vlerë ose transaksionet e riblerjes.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Kur aktivet i shiten një pale të tretë duke shkëmbyer normat totale të kthimit mbi asetet njëkohesisht, ky trajtohet si transaksion financiar i siguar i ngjashëm me një transaksion të riblerjes. Në disa transaksione të caktuara ku IFJB as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh aktivin nëse nuk ruan kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e ruajtura gjatë transferimit njihen me vete si aktive ose detyrime, sipas rastit. Në transferime ku kontrolli mbi aktivin ruhet, IFJB vazhdon të njohë aktivin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

(iv) *Kompensimi*

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur IFJB ka të drejtën ligjore për të shlyer shumën dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidh detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i transaksioneve të ngjashme siç është aktiviteti i IFJB-së.

(v) *Matja me kosto të amortizuar*

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) *Matja e vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose çmimi që do të paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm, ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut, ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku IFJB ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton rrezikun e mos-performancës së tij.

Kur është e mundur, IFJB e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive ose duke përdorur çmimet e kuotura të ndërmjetësuesve për instrumentet financiare të kuotara në tregje aktive. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksionet aktuale dhe të rregullta të tregjeve në bazë të marrëdhënieve normale në treg. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, IFJB bën matjen me vlerën e drejtë duke përdorur metodën e vlerësimit.

Metodat e vlerësimit përfshijnë metodën e vlerës aktuale neto, flukset monetare të skontuara, krahasime me instrumente financiare të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe metoda vlerësimi. Për këto instrumente financiare, të dhënat e përdorura në model nuk janë të vëzhgueshme.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi IFJB vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidence objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar përfshin mospagesën ose falimentimin e huamarrësit, ristrukturimin e huasë ose paradhënies nga IFJB me kushte që, në rrethana të tjera, IFJB nuk do ti kishte konsideruar, tregues se një huamarrës do të futet në probleme likuiditeti, vlera e kolateralit zvogëlohet ndjeshëm si pasojë e përkeqësimit të kushteve të tregut ose të dhëna të tjera të monitorueshme lidhur me një grup aktivesh sikurse lëvizjet e pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësit për shoqërinë, ose kushte ekonomike që janë në korrelacion me mos-pagesën ndaj IFJB-së. Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë. Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupet e aktiveve të tilla duke qenë tregues i aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që vlerësohen. Humbjet prej aktiveve të matura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë në mes të vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me nomën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen si fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes shtyrjes së normës së zbritjes. Kur një ngjarje pasuese bëhet shkak që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulët, atëherë ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes. IFJB fshin kreditë dhe paradhëniet për klientët kur ato janë përcaktuar të jenë të paarkëtueshme. Aktivet e paarkëtueshme janë fshirë nga fondi për zhvlerësim pasi janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për të rimarrë aktivin dhe shuma e humbjes është përcaktuar. Rimarrjet pasuese të shumave të fshira më parë janë njohur në fitimin ose humbjen e vitit.

3.4 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartemonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në Banka dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga IFJB në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientet

Kreditë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe IFJB nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kreditë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.6 Huamarrjet

Huamarrjet janë pjesë kryesore e burimeve të financimit të IFJB-ës. Huamarrjet maten fillimisht me vlerën e drejtë plus koston që i atribuohen direkt transaksionit, dhe më pas maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.7 Aktivet e riposeduara

Aktivitet e riposeduara përfaqësojnë aktivet jofinanciare të fituara nga IFJB në ekzekutim të kredive të vonuara dhe IFJB synon shitjen e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër. Aktivitet njihen fillimisht me vlerën e të cilën fitohen si inventarë brenda aktiveve të tjera dhe më pas maten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto ndërsa çdo ulje e vlerës së tyre njihet si humbje.

3.8 Prona dhe pajisjet

(I) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas koston minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimet. Kosto historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Softueri i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje. Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatesi të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve. Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve (llogaritur si diferencë mes të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese kapitalizohen vetëm kur vërtetohet që përfitime ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.8 Prona dhe pajisjet (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pronës dhe pajisjeve zhvlerësohen nga data kur ato janë të vlefshme për përdorim. Amortizimi llogaritet për të shlyer koston e artikujve të pronës dhe pajisjeve minus vlerat e përlllogaritura të mbetura të këtyre pasurive përgjatë jetës së parashikuar të përdorimit. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve.

Jetëgjatesia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

Ndërtesa	20 vite
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	5 vite
Automjete	5 vite
Mobilje dhe paisje	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qira zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit gjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe të jetës së tyre të dobishme. Metodatat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlerat e mbetura janë rivlerësuar në datën e raportimit dhe rregulluar atëherë kur duhet.

3.9 Pasuritë e paprekshme

Softuerët e blerë nga BiCredit janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje nga amortizimi. Shpenzimet pasuese mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike në asetin specifik më të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera njihen kur ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të pasurisë, që nga data që është i vlefshëm për përdorim. Softueri amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme për pesë vite. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

3.10. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.10 Aktivët me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16) (vazhdim)

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësishë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktiv i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, ku IFJB ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi dhe ka mundësi që një dalje e mjeteve monetare do të kërkohej për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritura të pasurive monetare me një norme para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Skontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

3.12 Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në ekuitet ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në fitimin/humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshme. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do ta percjellin menyrën në të cilën IFJB pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendos vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato kthehen, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit. Mjetet dhe detyrimet tatimore të shtyera kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlidhen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.12. Shpenzimet e tatimit (vazhdim)

Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive. Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet sipas tatimeve, kredive tatimore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pashfrytëzuara, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme, kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

3.13 Përfitimet e punonjësve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. BiCredit paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël kritike të BiCredit dhe zbatimin e tyre si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një rrezik të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe për gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura pasqyrat financiare të veçanta janë shpalosur më poshtë. Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e riskut financiar.

Dëmtimi

Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuar vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave të përshkruara të kontabilitetit në shënimin 3. IFJB rishikon portofolion e saj të kredive për të vlerësuar zhvlerësimin në baza të rregullta. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave apo jo, IFJB bënë gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të parasë nga portofolio e kredive para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portofolio. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, apo në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mungesa në pasuritë e IFJB-së. Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike të humbjeve për pasuritë me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolio kur bëhet caktimi i flukseve të ardhshme të parasë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohet rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe pervojës aktuale të humbjes. IFJB përcakton se investimet e vlefshme për shitje zhvlerësohen kur ka një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim se çfarë është e rëndësishme ose e shtyrë, kërkon një gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, IFJB vlerëson në mesin e faktorëve të tjerë, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm, kur ka prova të përkeqësimit në shëndetin financiar të të investuarit, performancës së industrisë dhe të sektorit, ndryshimet në teknologji dhe flukset operative dhe të financimit të rrjedhës së parave.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive bazohet në transaksionet e tregut të vëzhgueshme. Kur transaksionet e tregut të vëzhgueshme nuk janë të disponueshme, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modele vlerësimi, siç janë teknikat e skontuara të flukseve monetare. Futja në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë gjatë jetës dhe normat e interesit. Kreditë e vogla homogjene janë grupuar në portofole me karakteristika të ngjashme.

5. Administrimi i riskut financiar

Përdorimi i instrumenteve financiar e ekspozon kompaninë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- risku i kreditimit
- risku i likuiditetit
- risku operacional
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Institucionit ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Kompanisë.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut në IFJB. Bordi ka themeluar Komitetin e Kreditimit, i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në pjesët e tyre përkatëse. Politikat e menaxhimit të rrezikut janë vendosur me qëllim për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përballen IFJB, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. IFJB, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i kredisë

Risku i kredisë është risku që pala tjetër zotëruese e një instrumenti financiar do të dështojë për shlyerjen e detyrimit duke i shkaktuar kështu një humbje IFJB-së. IFJB menaxhon riskun e kredisë duke hyrë në marrëveshje vetëm me palë kundrejt kushteve të veçanta të kreditimit.

Ekspozimi kryesor i IFJB-së për riskun e kredisë lind nëpërmjet kredive dhe paradhënieve. Shuma e ekspozimit të kreditit në këtë drejtim është e përfaqësuar nga vlerat kontabël të aktiveve. Përqendrimi i riskut të kreditit që lind nga instrumentet financiare ekziston për palën tjetër kur ato kanë karakteristika të njëjta ekonomike të cilat do të shkaktonin aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të jenë njësoj të influancuara nga ndryshime në kushtet ekonomike ose të tjera. IFJB nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishme në lidhje me ndonjë konsumator individual apo palë tjetër. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditit është i përfaqësuar nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(i) Administrimi i riskut të kredisë

Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë të Komitetit i Kreditimit të saj. Departamentit të kredive i është kërkuar vendosja e politikave dhe procedurave dhe është përgjegjës për cilësinë dhe performancën e portofolit të kredisë dhe për monitorimin dhe kontrollin e të gjitha rreziqeve të kreditit në portofolin e tij. Politika e IFJB është që të kërkojë garanci të përshtatshme nga klientët para disbursimit të kredive të aprovuara. Kolaterali për kredi është marrë zakonisht në formën e hipotekave, automjetet / pajisjeve dhe mallrave.

(ii) Kredia

Kreditë e zhvlerësuar janë kredi për të cilat IFJB-së përcakton se është e mundshme që ajo nuk do të jetë në gjendje që të mbledhë të gjithë principalin dhe fitimet sipas termave kontraktuale në marrëveshjen e kredisë. Këto kredi janë kategorizuar në disa nivele sipas sistemit të brendshëm të kategorizimit të riskut të kredisë. Kreditë dhe investimet e vonuara por të pa-zhvlerësuar janë ato për të cilat pagesat e fitimit ose të principalit sipas kontratës, janë me vonesë por që Kompania beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të garancisë/kolateralit të vlefshëm dhe/ose shkallës së arkëtimit të shumës që i detyrohen Kompanisë.

(iii) Fondi për zhvlerësim

Kompania ka një fond për humbje nga zhvlerësimi që paraqet llogaritjen e humbjes në portofolin e kredive. Komponentët kryesorë të këtij fondi janë komponentë specifik të humbjes që lidhen me kreditë e testuara individualisht dhe fondi i zhvlerësimit për kreditë në grup ka një grup aktivesh homogjene në lidhje me humbjen e cila ka lindur por që nuk është identifikuar për kreditë e zhvlerësuar individualisht

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i kredisë (vazhdim)****(iv) Politika e nxjerrjes jashtë bilancit**

Kompania nxjerr jashtë bilanci një kredi (dhe çdo fond për humbjet nga zhvlerësimi) kur drejtuesit përcaktojnë që një kredi është e pamundur të paguhet. Ky përcaktim arrihet pasi merret në konsideratë informacioni për gjendjen financiare të kredimarrësit i cili nuk mund të paguajë detyrimin e tij, ose kur të ardhurat nga shitja e kolateralit nuk janë të mjaftueshme për të paguar të gjithë ekspozimin.

IFJB mund të fshijë një kredi (dhe çdo fond zhvlerësimi i lidhur me të) në bazë të një vendimi gjyqësor, kur nuk ka më asnjë mundësi për ta arkëtuar kredinë. IFJB mban kolateral kundrejt kredive dhe paradhënie për klientët, në formën e hipotekave, automjeteve / pajisjeve dhe mallrave. Vlerësimet e vlerës së drejtë janë të bazuar në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e kredimarrjes. Ekspozimi i kolateralit është të paktën 100% të shumës së kredisë së lëvruar.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paraja dhe ekuivalente e saj	269,604	552,273
Kredite dhe avancat për klientët, neto	3,460,958	3,192,306
	3,730,562	3,744,579

Kualiteti i kredive sipas klasës së pasurisë financiare është si më poshtë:

31 dhjetor 2021	As në vonesë e as të provizionuara	Në vonesë por jo të provizionuara	Në vonesë dhe të provizionuara	Totali
Paraja në banka	269,604			269,604
Kreditë dhe avanset për klientët	3,498,838		88,444	3,587,282
Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	3,768,442	-	88,444	3,856,886
31 dhjetor 2020	As në vonesë e as të provizionuara	Në vonesë por jo të provizionuara	Në vonesë dhe të provizionuara	Totali
Paraja në banka	552,273	-	-	552,273
Kreditë dhe avanset për klientët	3,190,172	-	95,720	3,285,892
Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	3,742,445	-	95,720	3,838,165

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i kredisë (vazhdim)**

Analiza e ekspozimit të rrezikut kreditor sipas ditë vonesave është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Standarde (0 ditë në vonesë)	3,422,999	3,125,625
Standarde (0-30 ditë në vonesë)	36,084	82,277
Vrojtuese (31-60 ditë në vonesë)	25,928	15,219
Nën-standard (61-90 ditë në vonesë)	27,292	642
Të dyshimta (91-180 ditë në vonesë)	13,732	6,924
Të humbura (mbi 180 ditë në vonesë)	32,178	30,337
Interesi akrual	29,068	24,868
Minus: Tarifa e shtyrë e disbursimit	(37,880)	(29,230)
Totali i kredive	3,549,401	3,256,662
Minus: Provizion për humbjet nga kreditë	(88,443)	(64,356)
Totali i kredive dhe avansave për klientët, neto	3,460,958	3,192,306

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që IFJB do të hasë në vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj financiare.

(i) Administrimi i Riskut të likuiditetit

Përqasja e IFJB në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, me sa është e mundur, që ajo do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kushte normale dhe të vështira, pa pasur humbje të papranueshme ose risqe që dëmtojnë reputacionin e IFJB. Pozicioni i likuiditetit të IFJB monitorohet nga Departamenti i Financave në bazë javore/mujore dhe vjetore duke menaxhuar disponibilitetin e mjeteve monetare për disbursimin e kredive dhe duke siguruar që ka fonde të mjaftueshme për hyrjet dhe daljet e pritshme të llogarive në mënyrë që të përmbushë detyrimet e IFJB.

(ii) Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit

Burimi kryesor i financimit të IFJB-së është kapitali aksionar. IFJB mban detyrime ndaj kredisë, që do të thotë se financimi i aktivitetit bëhet nga kapitali aksionar i rëndomtë prej pronarit dhe detyrimeve ndaj kredisë. IFJB vlerëson vazhdimisht riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në fondet e nevojshme për të përmbushur objektivat e biznesit dhe objektivat e përcaktuara në terma të strategjisë së përgjithshme të IFJB-së. Gjithashtu IFJB mban një portofol aktivesh likuide si pjesë e strategjisë së saj të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2021

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Pasuritë						
Paraja në banka	269,604					269,604
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	-	102	195,743	3,302,993	-	3,498,838
Total	269,604	102	195,743	3,302,993	-	3,768,442
Detyrimet						
Huatë	(53,040)	(39,286)	(287,107)	(740,643)		(1,120,076)
Detyrime të tjera	(3,238)	(8,406)	(16,619)	(56,504)	(16,414)	(101,181)
Total	(56,278)	(47,692)	(303,726)	(797,147)	(16,414)	(1,221,257)
Pozicioni neto	213,326	(47,590)	(107,983)	2,505,846	(16,414)	2,547,185
Pozicioni kumulativ neto	213,326	165,736	57,753	2,563,599	2,547,185	-

31 dhjetor 2020

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Pasuritë						
Paraja në banka	552,273					552,273
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	96,314	352,736	1,182,506	1,583,237	6,743	3,221,536
Total	648,587	352,736	1,182,506	1,583,237	6,743	3,773,809
Detyrimet						
Huatë	(53,268)	(39,286)	(267,107)	(936,786)		(1,296,447)
Detyrime të tjera	(13,560)	(8,283)	(23,931)	(64,502)	(31,336)	(141,612)
Total	(66,828)	(47,569)	(291,038)	(1,001,288)	(31,336)	(1,438,059)
Pozicioni neto	581,759	305,167	891,468	581,949	(24,593)	2,335,750
Pozicioni kumulativ neto	581,759	886,926	1,778,394	2,360,343	2,335,750	-

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku operacional

Risku Operacional përbën rrezikun e humbjes i cili rezulton nga proceset e brendshme joadekuade apo të dështuara, njerëzit dhe sistemet apo nga ndodhitë e jashtme. Risku operacional shoqërohet me gabimet njerëzore, dështimet e sistemit dhe procedurat apo kontrollat joadekuade. Ai është një rrezik nga humbja që vë nga mundësia që sistemi joadekuat informativ, dështimet teknologjike, shkeljet në kontrollin e brendshëm, mashtrimet, fatkeqësitë e paparashikuara, apo problemet tjera operacionale mund të rezultojnë në humbje të papritura apo probleme të reputacionit. Risku operacional ekziston në të gjitha produktet dhe aktivitetet e biznesit.

Llojet e ndodhive të riskut operacional të cilat kanë potencial për të rezultuar me humbje substanciale përfshijnë mashtrimin e brendshëm, mashtrimin e jashtëm, praktikat e punësimit dhe sigurinë në vendin e punës, klientët, produktet dhe praktikat biznesore, çrregullimet biznesore dhe dështimet e sistemeve, dëmtimet në asetet fizike, dhe në fund menaxhimi i ekzekutimit, ofrimit dhe proceseve. Qëllimi i menaxhimit të riskut operacional është i njëjtë sikur ai për riskun kreditor, të tregut dhe të likuiditetit që është të gjejnë shkallën e ekspozimit të riskut operacional të institucionit financiar, për të kuptuar se çka e drejton atë, për të alokuar kapitalin përkatës kundrejt atij ekspozimi dhe për të identifikuar trendet përbrenda dhe nga jashtë që do të ndihmojnë në parashikimin e tij.

Menaxhimi i rreziqeve specifike operacionale nuk është një praktikë e re; ka qenë gjithmonë i rëndësishëm për Bankat/institucionet mikrofinanciare, IFJB-të për të evituar mashtrimet, për të mirëmbajtur integritetin e kontrollit të brendshëm, dhe të zvogëlojë gabimet në procesimin e transaksioneve, e kështu me radhë. Sidoqoftë, dështimi për të kuptuar dhe menaxhuar mirë riskun operacional, i cili është prezent praktikisht në të gjitha transaksionet dhe aktivitetet IFJB, mundet të rrisë shumë mundësinë që disa rreziqe do të kalojnë pa u vërejtur dhe të pakontrolluara.

(i) Llojet e Rreziqeve operacionale

Llojet e ndodhive të riskut operacional të cilat kanë potencial që të shkaktojnë humbje substanciale përfshijnë:

- Mashtrimet e brendshme. Për shembull, keq-raportimi i qëllimshëm i pozicioneve, vjedhjet e punëtorëve, dhe tregtimi i brendshëm në llogari të vet punëtorit/stafit.
- Mashtrimet e jashtme. Për shembull, vjedhje/grabitje, falsifikim, dëmet nga pirateria kompjuterike.
- Praktikrat e punësimit dhe sigurinë e vendit të punës.
- Injorimi i Politikës, Procedurave, Strategjisë, Udhëzimeve, dhe Rregulloreve të Institucionit dhe përdorimi jo-adekuat apo joefektiv i mekanizmave ekzistues të kontrollit nga ana e personelit të Institucionit financiar në lidhje me ndonjë klientë potencial, apo
- Përpjekja për të aplikuar "kanalet e shkurtëra" ("shortcuts") për të avancuar agjendat personale.
- Praktikrat e marrdhënieve me Klientë, të Produkteve, dhe Biznesit. Për shembull, shkeljet konfidenciale, keqpërdorimi i informacioneve të besueshme të klientit, aktivitetet joadekuade të transaksioneve në llogarinë e Institucionit, shpërlarje e parasë, dhe shitja e produkteve të paautorizuara.
- Dëmet në asetet fizike. Për shembull, terrorizmi, vandalizmi, tërmetet, zjarri dhe vërshimet.

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku operacional (vazhdim)

(i) Llojet e Rreziqeve operacionale (vazhdim)

- Përçarja e biznesit dhe dështimi i sistemit. Për shembull, dështimet e hardverit dhe softwerit, problemet e telekomunikimit, dhe ndërprerja e furnizimeve publike (rrymes/ujit, etj.).
- Menaxhimi i ekzekutimit, realizimit, dhe proceseve. Për shembull, gabimet në hyrje e të dhënave në sistem, dështimet në menaxhimin e kolateralit, dokumentacioni i pakompletuar ligjor, keq-përformanca e palës së tretë, dhe kontestimet e partnerëve shitës.

(ii) Parimet e menaxhimit të riskut operacional

- Strategjia e qartë e adoptuar nga Bordi i Drejtorëve dhe mbikëqyrja e ushtruar nga menaxhmenti i lartë;
- Kultura e fortë e riskut të brendshëm operacional (Kultura e brendshme e riskut operacional nënkupton në këtë rast tërësinë e kombinuar të vlerave individuale dhe korporative, qëndrimeve,;
- Kompetencave dhe sjelljeve të cilat përcaktojnë zotimin e vendosur të kompanisë në stilin e menaxhimit të riskut operacional) dhe kultura e kontrollit të brendshëm (me theks kontrollet duale);
- Monitorim efektiv dhe raportim të brendshëm;
- Planet kontingjente dhe të vazhdimësisë së biznesit;
- Standarde të larta të etikës dhe integritetit; dhe
- Zotimi për qeverisje efektive korporative, përfshirë, përveç tjerash, ndarjen e detyrave, shmangien e konflikteve të interesit, dhe linjat e qarta të përgjegjësisë menaxheriale, llogaridhënies dhe raportimit; të gjitha nivelet e stafit duhet të kuptojnë përgjegjësitë e veta me respekt në menaxhimin e riskut operacional.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si normat e interesit, çmimi i kapitalit, kurset e këmbimit dhe marzhet e interesave të kredisë (jo të lidhura me ndryshimet në pozicionin e kreditit të detyruesit/emetuesit) do të ndikojnë në ardhurat e IFJB-ës ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i administrimit të riskut të tregut është që të administrojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranuar duke optimizuar kthimin për riskun e pranuar.

(i) Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Aktivitetet e menaxhimit të rriskut kanë për qëllim optimizimin e të ardhurave neto nga interesi, duke patur parasysh që nivelet e interesit të tregut të jenë në përputhje me strategjitë e IFJB -ës.

(ii) Ekspozimi ndaj kursit të këmbimit – portofoli jo i tregtueshëm

Risku i kursit të këmbimit është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit të huaj. IFJB menaxhon këtë rrezik duke siguruar që të gjitha asetet dhe detyrimet e saj të jenë në Euro.

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2021

	EUR	USD	Totali
Pasuritë			
Paraja në banka	269,604		269,604
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	3,536,718		3,536,718
Total	3,806,322	-	3,806,322
Detyrimet			
Huatë	(1,120,076)		(1,120,076)
Detyrime të tjera	(101,944)		(101,944)
Total	(1,222,020)	-	(1,222,020)
Pozicioni neto	2,584,302	-	2,584,302
Pozicioni kumulativ neto	2,584,302	-	2,584,302

31 dhjetor 2020

	EUR	USD	Totali
Pasuritë			
Paraja në banka	552,273		552,273
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	3,221,536		3,221,536
Total	3,773,809	-	3,773,809
Detyrimet			
Huatë	(1,296,447)		(1,296,447)
Detyrime të tjera	(141,612)		(141,612)
Total	(1,438,059)	-	(1,438,059)
Pozicioni neto	2,335,750	-	2,335,750
Pozicioni kumulativ neto	2,335,750	-	2,335,750

6. Menaxhimi i kapitalit

Politika e IFJB-ës është që të mbajë një nivel stabil të bazës së saj kapitale si dhe të ruaj besimin e tregut dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Nuk ka pasur ndryshime në politikën e menaxhimit të kapitalit gjatë vitit.

7. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Supozimet kryesore lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të pasigurisë në vlerësim në datën e raportimit, të cilat kanë një rrezik të rëndësishëm në kryerjen e korigjimeve materiale të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë diskutuar më poshtë. Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht dhe janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë parashikimet e ngjarjeve të ardhshme që besohet se janë të arsyeshme sipas rrethanave.

8. Të ardhurat neto nga interesi

Të ardhurat neto nga interesi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si në vijim:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesi		
Kreditë dhe paradhënie për klientët	520,393	500,376
	520,393	500,376
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime interesi qera financiare	(6,573)	(8,130)
Shpenzime interesi për huatë nga banka	(64,011)	(67,432)
	(70,584)	(75,562)
Të ardhurat neto nga interesi	449,809	424,814

9. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si në vijim:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tarifa dhe komisione të tjera	40,846	35,261
	40,846	35,261
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime për tarifat dhe komisionet		
Tarifa dhe komisione bankare	-	(312)
	-	(312)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	40,846	34,949

10. Kthimi nga kreditë e shlyera

Kthimi nga kreditë e shlyera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si në vijim:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Te hyrat nga ndryshimi i pengut	4,210	3,254
	4,210	3,254

11. Të ardhura të tjera operative

Të ardhurat e tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si në vijim:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Te ardhura te tjera- rimatja e kontratave të qirase financiare	-	3,562
	<u>-</u>	<u>3,562</u>

12. Shpenzimet e tjera operative

Shpenzimet e tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si në vijim:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzimet e provizionit të kredive	33,142	12,764
Gjithsej	<u>33,142</u>	<u>12,764</u>

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzimet adm. dhe zyrës	6,142	8,115
Shpenzimet e auditimit	3,700	3,380
Shpenzimet e automjeteve	120	255
Shpenzimet e komunalive (rrymë, ujë, mbeturina)	6,139	5,257
Shpenzimet e marketingut	2,336	50
Shpenzimet për CRK_BQK	2,008	1,171
Shpenzimet e sigurimit (objekt, cash)	5,748	9,978
Shpenzimet e tarifave bankare	1,031	451
Shpenzimet e zhvlerësimit	70,848	70,519
Shpenzimet për internet dhe telefon	8,815	7,406
Shpenzimet për licensim	2,284	742
Shpenzime per donacione	2,000	-
Shpenzime për mirmbajtje të sistemit të kredive	10,272	10,002
Shpenzimet e derivative	6,413	3,234
Shpenzimet e reprezentacionit	699	1,260
Shpenzimet e tjera	12,491	9,061
	<u>141,046</u>	<u>130,881</u>

12. Shpenzimet e tjera operative (vazhdim)

Numri i të punësuarve me 31 dhjetor 2021 është 31 punonjës.

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga dhe meditje	156,250	147,162
Kontributi personal	7,771	7,316
	164,021	154,478
Totali i shpenzimeve operative	338,209	298,123

13. Tatimi në fitim

Tatimi në të ardhurat e korporatave është përfshirë në pasqyrat financiare në pajtim me legjislacionin tatimor në Kosovë: Ligjit nr.05-L029 për vitin 2019 dhe rregulloret tjera plotësuese aktuale sipas këtij ligji tatimi në fitim është 10%.

Shpenzimet e tatimit në fitim për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi/(humbja) para tatimit	156,656	168,456
Korrigjim per: shpenzimet e panjohura	10,039	2,981
Humbjet e bartura	-	-
Fitimi i tatueshem	166,695	171,437
Obligimi tatim fitimit para sponsorizimeve	16,669	17,144
Sponsorizimi	-	(1,000)
Obligimi tatim fitimit per vitin	(16,669)	(16,144)
Fitim/Humbja Neto	139,987	152,312

16. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Paratë e gatshme	21,950	15,347
Paraja në bankë	247,654	536,926
Gjithsej	269,604	552,273

17. Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si në vijim:

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	35,220	35,220
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	35,220	35,220
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	35,220	35,220
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2020	15,830	15,830
Amortizimi i vitit	7,044	7,044
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	22,874	22,874
Amortizimi i vitit	7,044	7,044
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	29,918	29,918
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	12,346	12,346
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	5,302	5,302

18. Prona dhe pajisje

Pronat dhe pajisjet më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si në vijim:

	Inventari dhe Pajisje	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2020	106,229	23,165	52,084	181,478
Pakësime			(28,777)	(28,777)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	106,229	23,165	23,307	152,701
 Shtesa		1,135		1,135
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	106,229	24,300	23,307	153,836
 Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2020	36,115	9,537	14,447	60,099
Amortizimi i vitit	22,041	3,840	4,516	30,397
Kthim amortizimi	-	-	(6,746)	(6,746)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	58,156	13,377	12,217	83,750
 Amortizimi i vitit	21,068	4,860	4,517	30,445
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	79,224	18,237	16,734	114,195
 Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2020	48,073	9,788	11,090	68,951
Gjendja më 31 dhjetor 2021	27,005	6,063	6,573	39,641

19. Asete me të drejtë përdorimi

Asetet me të drejtë përdorimi më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si në vijim:

	Asete me të drejtë përdorimi	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	162,926	162,926
Shtesa	25,537	25,537
Gjendja më 31 dhjetor 2020	188,463	188,463
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	188,463	188,463
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2020	30,846	30,846
Amortizimi i vitit	33,078	33,078
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	63,924	63,924
Amortizimi i vitit	33,360	33,360
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	97,284	97,284
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	124,539	124,539
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	91,179	91,179

Kompania ka aplikuar SNRF 16 nga janari 2019. Kompania ka kontrate qeraje me subjektet si më poshtë:

- Ajshe Hyseni per Ndërtesën. Kohe zgjatja e kontrates eshte 44 muaj duke filluar nga janari 2019.
- Genc Krasniqi për ndërtesën. Kohe zgjatja e kontratës është 37 muaj duke filluar nga janari 2020. Për këtë kontratë ka patur një amendim përgjatë vitit 2020, pasi më pare ka patur një kohë zgjatje 52 muaj duke filluar nga janari 2019.
- Shyqyri Arifi per ndërtesën. Kohë zgjatja e kontratës është 109 muaj duke filluar nga marsi 2020. Për këtë kontratë ka patur një amendim përgjatë vitit 2020, pasi më pare ka patur një kohë zgjatje 121 muaj duke filluar nga marsi 2019.

Pagesat mujore te qerases jane skontuar me normen e tregut bazuar ne normat e BQK-së.

20. Detyrimet e tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrimet ndaj tatimit në fitim	-	7,014
Detyrime për qera financiare	95,839	131,463
Detyrimet ndaj furnitorëve	5,342	3,135
Detyrimet tjera	45,569	35,294
Gjithësej detyrime tjera	146,750	176,906

Qiraja financiare sipas kohëzgjatjes është:

	31 dhjetor 2021
Pjesa afatshkurtër	32,322
Pjesa afatgjatë	63,517
	95,839

Informacion më i detajuar për qerane financiare paraqitet në tabelën si më poshtë:

Njesia	Qira financiare	Pagesat	Gjendja në fund
Prishtine	51,374	23,736	30,277
Lipjan	69,868	10,549	62,982
Ferizaj	6,265	3,956	2,580
			95,839

21. Hua nga bankat

Huatë nga institucionet bankare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime huaje	1,116,786	1,292,929
Interesi akrual	3,290	3,518
	1,120,076	1,296,447

22. Kapitali aksionar dhe rezervat

Më 31 dhjetor 2021 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 10,000 aksione të zakonshme. Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 230.00 Euro secili. Pronarja e aksioneve të zakonshme ka të drejtë të marrë dividend që deklarohet kohë pas kohe dhe ka të drejtë vote në mbledhjet e Kompanisë.

Emri i Aksionares	Nr. i Aksioneve	Çmimi i aksionit	Kapitali Aksionar
Valdete Hyseni Fazliu	10,000	230.00	2,300,000

23. Zotimet dhe kontingjentet

Ligjore

IFJB nuk është i përfshirë në asnjë procedurë ligjore gjatë vitit 2021.

Zotimet

Nuk ka ndonjë zotim domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

24. Transaksione me palët e lidhura

Palët e lidhura përfshijnë aksionaret dhe menaxhmentin e Institucionit Financiar JoBankar. Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur transaksione me palët e lidhura.

25. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë të pasqyrat financiare.

